



KOMUNA E KLINËS
KUVENDI I KOMUNËS

01.Nr. 06-2278/12
KLINË, 30.3.2017

**PROCESVERBAL I SEANCËS SË III-të TË KK, MBAJTUR, MË 30.3.2017, NË ORËN
13:00, NË SALLËN E KK**

Në seancë prezantuan: Kryetari i Komunës, Sokol Bashota, kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, anëtarët e KK (26), drejtorë të drejtorive, Zyra ligjore, Zyra e auditimit, Policia e Kosovës, komandanti Rexhë Berisha, KFOR-i, OSBE, Zyra e Komisionit komunal zgjedhor, Skënder Morina, OJQ "Koha", mediet etj.

Mbledhjen e hapi dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KK, dr. Haxhi Ibishi, i cili fillimisht të pranishmëve ju dëshiroi mirëseardhje në këtë seancë të KK. Në vijim kryesuesi Ibishi, njoftoi anëtarët që është një kërkesë e kryetarit të Komunës, që në pikën 9 të rendit të ditës të përfshihet një njoftim që kryetari do të na prezantojë

“Materialin e keni marrë bashkë me ftesën, hapi diskutimin rreth rendit të ditës”, tha kryesuesi Ibishi.

Nuk pati debate rreth rendit të ditës.

Kryesuesi vuri në miratim rendin e ditës

Me vota unanime u miratua ky

R E N D I I D I T Ë S

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për bartje të mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2016 në vitin 2017 (ref. Drejtoria e FEZH),
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, Nr.01-434-5712/2014 të datës 26.12.2014,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për ndarje të bursave për studentët e Komunës së Klinës,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe

- Sportit për subvencionimin e Festivalit Folklorik “I Këndojmë Lirisë” 2017,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për ndarje të ngastrës për ndërtim të Qendrës Rinore në Klinë,
 8. Pyetje dhe përgjigjeje nga këshilltarët e Kuvendit,
 9. Propozimi i kryetarit të Komunës, Sokol Bashota për ndarjen e Çmimit “Nderi i Qytetit” për pedagogun, veprimtarin dhe atdhetarin Ismet Rraci.

Pika e parë: Arsyetimi i mungesave.

Kryesuesi sqaroi se ka dy arsye të mungesave, për Marije Selmanajn, e cila gjendet në spital, po ashtu edhe për Qamile Qitakun, e cili gjendet jashtë vendit.

Pika e dytë: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.

Kryesuesi Ibishim, hapi diskutimin rreth procesverbalit të seancës së kaluar. Nuk pati debate nga ana e anëtarëve. Kryesuesi vuri në miratim procesverbalin e seancës së kaluar.

Me vota unanime (24), u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

Pika e tretë: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për bartje të mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2016 në vitin 2017 (ref. Drejtorja e FEZH).

Kryesuesi fjalën e barti te drejtori i Drejtorisë së FEZH, z. Ramiz Rrusta.

Ramiz Rrusta (drejtor i Drejtorisë së FEZH), raportoi rreth kërkesës së bartjes së mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2016 në vitin 2017. “Ju kërkoj falje anëtarëve të KPF-së që në seancën e fundit kam munguar me arsyetim, megjithatë më kanë zëvendësuar zyrtarët e drejtorisë”, theksoi drejtori Rrusta, i cili në vijim foli rreth kërkesës së bartjes së mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2016 në vitin 2017. Materialin e keni përpara dhe shifrat të gjitha i keni të specifikuar. Të hyrat vetanake të vitit 2015 dhe 2016 në total janë në shumën prej 328,662.55 €, të cilat i bartim për vitin 2017 dhe shpërndarja e tyre është nëpër programet dhe nën-programet buxhetore dhe kategoritë ekonomike të shpenzimeve, si vijon: Paga dhe mëditje 6,700.42 €; mallra dhe shërbime në shumë prej 11,355.74 €; shpenzime komunale në shumë prej 147.17 €; subvencione dhe transfere në shumë prej 12,468.18 € dhe shpenzime kapitale në shumë prej 297,991.04 €. Në kategorinë ekonomike, paga dhe mëditje shuma prej 6,700.42 € në programin: Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale (730) nën-programi (74050). Në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime shuma prej 11,355.74 € në programet si vijon: Administrata dhe personeli (163), nën-programi (16318) shuma prej 7,182.50 €; Buxhet dhe Financa (175) nën programi (17518) shuma prej 434.81€ Arsimi dhe Shkenca (920) nën-programi (92090) shuma prej 3,738.43 €. Në kategorinë ekonomike shpenzime komunale shuma prej 147.17 € në programin: Buxhet e financa (175) nën-programi (17518) . Në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shuma prej 12,468.18 € në programin: Zyra e Kryetarit (160) nën-programi (16018). Në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale shuma prej 297,991.04 € në programet si vijon: Në programin Shërbimet Publike Mbrojtja Civile (180) nën-programi (18018) në projektet : Mirëmbajtja e rrugëve , kodi (43798) shuma prej 12,425.10 €; Mirëmbajtja e hapësirave publike dhe ndriçimi, kodi (90065) shuma prej 6,899.78 €; Ndihmë për nevoja emergjente , kodi (88253) shuma prej

340.06 €; Në programin Kadastra dhe Gjeodezia (650) nën-programi (65090) në projektin: Furnizimi me aparat gjeodezik, kodi (90072) shuma prej 15,000.00 €; Në Programin Planifikimi urban dhe mjedisi (660) nën-programi (66395) në projektet; bashkëfinancim me donatorë), kodi (43803) shuma prej 45,855.10 €; ndërtimi me gur i Sheshit dhe rrugëve në qytet , kodi (43804) shuma prej 187,471.00; Hartat zonale, kodi (43815) shuma prej 30,000.00 €”, ka raportuar ndër të tjera drejtori Rrusta, i cili në fund kërkoj nga anëtarët që ta aprovojnë këtë bartje të mjeteve nga viti 2016 në vitin 2017, për ndonjë sqarim unë gjendem këtu dhe mund t’ju jap shpjegime”, ka konstatuar drejtori Rrusta.

Kryesuesi Ibishi, hapi diskutimin.

Pal Berisha, tha se unë pata një pyetje për drejtorin, ai tha që nuk ka qenë prezent në KPF. “Në KPF na është thënë se barten mjete prej vitit 2015 dhe 2016. Tani ne po shohim bartje të mjeteve vetëm nga viti 2016 në 2017, a keni mundësi të na sqaroni”, tha anëtari Berisha.

Fadil Gashi, tha se ne kemi biseduar kush kemi qenë anëtarë të KPF-së, mirë është që drejtori tash është prezent këtu. “Ne kemi pasur një debat me zyrtaren e drejtorit këtu që është, pak rrëshqitazi e përmendi edhe drejtori. Unë prapë po e përsëritet ajo që kemi folur në KPF. Është hera e parë që shohim një shkresë që barten mjetet prej 2015, në 2016 dhe 2017. Domethënë diçka që nuk na ka ndodhur më herët, sepse ne më 2016 e kemi bërë bartjen e mjeteve prej 2015 në 2016 dhe tash unë nuk po mund të gjej arsye, edhe po i them edhe drejtorit, edhe të tjerëve, se nëse ne nuk jemi ekonomistë, ne konsultohemi me ta, edhe i shqyrtojmë çështjet me ta, lëre më që kemi marrë pjesë edhe në hartim të buxhetit, në ndarjen, planifikimin etj. Unë edhe një herë po e them, për mua është veç pjesa e ndërtimit të sheshit bartja e këtyre mjeteve 297 000 euro, që është diskutabile që ne nuk e pranojmë për shkak të kësaj, që tash po paralajmëroj se ne do të votojmë kundër, krejt këto të tjerat janë reale, janë të mundshme, janë ligjore ashtu qysh po thotë drejtori, sepse nuk është hera e parë që në po bëjmë bartje të mjeteve. Por tek këto ndryshon. Edhe unë po besoj se edhe në paraqitjen e zyrtares atë ditë, edhe sot drejtori, po shihet se diçka nuk është krejt okej, sepse s’po ka mundësi për t’iu gjetur as emërtimi i njëjtë. Zyrtarja atë ditë e potencoi “nuk ka mundësi një shkronjë t’i mungojë titullit”, ndërsa referojuni kontratës qysh është, është tjetër kontratë, është tjetër qysh këtu na vjen, edhe është krejt diçka tjetër qysh e kam thënë atë ditë, qysh drejtori i Urbanizmit e ka deklaruar publikisht në Radio Alba dhe kush e ka pasur rastin ta dëgjojë. Prandaj, një projekt me tre tituj, me shuma të ndryshme, ne nuk dimë realisht çfarë jemi duke votuar, prandaj, është e papranueshme për ne, edhe ne në këtë rast votojmë kundër”, ka konstatuar anëtari Gashi.

Rasim Millaku, tha se mua më rrëshqiti qysh në fillim desha ta ngre një çështje që do të kishte të bëjë me siguri edhe me rend të ditës. “Arsyeja e kontributit tim është pikërisht te drejtorja e Ekonomisë. Janë disa vendime të Kuvendit që nuk po zbatohen. Edhe mund t’i potencoj të gjitha po që se ka nevojë, duke filluar prej komiteteve, seancave të jashtëzakonshme, duke filluar prej vendimeve për shërbime material teknik, për komisione të ndryshme, lap – top etj., të gjitha këto vendime i kemi marrë këtu dhe nuk zbatohen nga drejtorja për Ekonomi. Kështu që në “shenjë respekti” kisha për të thënë Drejtorja për Ekonomi nuk ka nevojë për neve, pse me i prurë pikat e rendit të ditës për të kontribuar në të to. Le t’i kalojë Ekzekutivi vetë këto pika, se nuk na i zbaton vendimet tona, sepse unë sa po hulumtojmë në asnjë komunë nuk ndodh të mos paguhen komitetet, të mos paguhen vendimet e Kuvendit. Këtu janë marrë disa vendime, në Kuvend, i

kemi votuar, shpeshherë unanimisht, edhe në shumicën e rasteve me shumicë të votave, por një vendim i Kuvendit kujtoj që konsultohet ligjshmëria e tij edhe nëse bëhet i plotfuqishëm jam për t'u zbatuar. Si shenjë respekti, në thonjëza po e them, unë jam të mos kontribuojmë në dy pikat e Drejtorisë për Ekonomi, për faktin që Drejtoria e Ekonomisë nuk po i zbaton vendimet tona, nuk po na del hakut neve, pse t'i kontribuojmë ne?! Le t'i kalojë drejtoria këto dy pika në drejtori, kështu po shprehem, edhe le të ecet tutje”, ka shtuar anëtari Millaku.

Tunë Dedaj, tha se edhe në grupi i AAK-së nuk e votojmë. “Problemi numër një është që kisha për t'u pajtuar me dy diskutuesit të mëparshëm, sepse është shumë e vërtetë vendimet që i bien kjo AK nuk zbatohen në pagesa. Vetë thonë që duhet të paguhen, vetë nuk i paguajnë. Edhe çka është më shqetësuese bartja e mjeteve prej vitit 2015 për të kaluar në vitin 2017. Ka pasur kohë një vit ato para për t'u përcaktuar”, ka thënë anëtari Dedaj.

Hasime Dauti, tha se ju e dini shumë mirë këshilltarë të këtij Kuvendi që Komisioni për emërtimin e rrugëve, i përbërë prej 9 anëtarësh, kemi bërë mbi 20 takime, edhe bukur me fjalosje, edhe kërcënime, që nuk kanë qenë të lehta. “Nga ky Kuvend është caktuar edhe sasia e mjeteve; nga ky kuvend është miratuar edhe vendimi për ndarjen dhe sot kësaj dite nuk ka asgjë, a thua mos është më së miri të paguhen një herë mjetet, pasi paska rezervë apo diçka tjetër”, shtoi anëtarja Dauti.

Ndue Shabanaj, tha se unë desha ta bart një shqetësim që kam prezantuar në KPF lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, jo shqetësim, por më tepër kam kërkuar sqarim. “Të gjitha këto sqarime që janë të nevojshme është mirë për t'i paraqitur para AK, vetëm këto shifra që janë këtu nuk flasin mjaft pa i arsyetuar ato. Kështu e kam thënë edhe ne KPF dhe dua ta them edhe këtu, për mjetet e bartura prej vitit 2015 duhet sqarim, duhet sqarim për të gjithë anëtarët e KK. Çështje tjetër është pozicionimi për të votuar për ose kundër, por sqarimi detyrimisht është i nevojshëm edhe i domosdoshëm. Të gjithë e kuptojmë se ka nevojë të barten mjetet financiare buxhetore nga një vit në një vit tjetër për shkak të përfundimit të vitit fiskal para përfundimit të vitit kalendarik që e dimë ne të gjithë, veçanërisht për investime kapitale dhe çështje tjera. Por, kur sqarohen këto, domethënë ne e akceptojmë më lehtë këto ndryshime t'i pranojmë ose t'i shpallim të paarsyeshme dhe të japim ne ato sugjerimet dhe vërejtjet tona. Edhe për këtë unë them se është mirë në detale për këtë të sqarohemi dhe pastaj votimi është çështje e anëtarëve të Asamblesë”, ka konstatuar prof. Shabanaj.

Ramiz Rrusta, tha se edhe një herë po ju them se në fillim mjetet që janë bartur për 2015 kanë qenë projekte të papërfunduara, prandaj ato mjete barten. “Edhe një herë e thashë nuk mund të bëjmë pagesa pa u kryer punët dhe pa ardhur fatura e pranimi të punëve dhe për t'u bërë pagesat. Ky është buxhet, edhe e sqarova mirë, që tre muaj të fundit, këto janë të hyra vetanake, ne duhet ndoshta për të qenë të kënaqur që kemi arritur në vlerë 210 mijë euro brenda tre muajve për t'u arkëtuar të hyra vetanake Komunës. Këtu nuk kemi të bëjmë me buxhetin se buxhetin për vitin 2017 veç e keni miratuar edhe është ai buxhet çfarë ju e keni votuar. Këto janë mjete që duhet të barten, këto janë mjete, nëse ju doni që këto mjete të kalojnë në suficit apo të mos jenë të arsyeshme për t'u shpenzuar, atëherë do ta bartni barrën ju. Kjo është gjithçka ligjore. Komunitat tjera kanë mbi 1 milion mjete të bartura nga vitet e kaluara 2015 në 2016 e 2017, sepse jam në kontakt me drejtorë tjerë. Te çështja që ngriti Rasimi, unë zakonisht kam respektuar Udhëzimin që ka ardhur prej MF, që në komisione nuk mund të paguhen ata të cilët e marrin një

pagë nga BKK. Asgjë tjetër nuk kemi bërë, këtë udhëzim kemi respektuar ne. Kemi pasur bisedë edhe për seancën e jashtëzakonshme, që keni mbajtur, ju e dini fare mirë se buxheti për AK, për seancat që mbani ju, ndahet 1/12 pjesë e buxhetit çdo muaj. Edhe ne atë seancë të jashtëzakonshme që ju e keni mbajtur ne mund ta paguajmë vetëm në seancën e gushtit. Merreni buxhetin që ju e keni çuar dorën për t'u aprovuar për 2017. I keni saktë dhe qartë sa mjete i ka AK, për sa seanca për t'u mbajtur. Mjete tjera nuk lejohen me kode buxhetore. Plus këtë vit i kemi edhe nëntë kode tjera, që nuk lejojnë që mjetet prej një kodi tjetër të barten në një kod tjetër. Po ju them edhe një herë: këto janë mjete dhe fatbardhësisht ne duhet për të qenë të kënaqur që janë realizuar të hyrat vetanake për tre muaj 210 mijë euro. Sa i përket emërtimit të sheshit, unë këtu e kam të shkruar, “ndërtimi me gur i sheshit dhe rrugëve në qytet, kodi 43804”. Domethënë shuma prej 187471 euro kalon, sepse pjesa më e madhe, unë e thashë edhe një herë, fatbardhësisht Qeveria na i ka ndarë 130 mijë euro dhe kjo e lehtëson ngarkesën e të hyrave vetanake që ne i inkasojmë. Nuk ka asgjë të keqe, gjithçka është ligjore. Sikur të mos ishte ligjore nuk do të kishte kaluar në MF atje”, ka sqaruar drejtori Rrusta.

Pjetër Coli, tha se kam një pyetje për drejtorin: nëse e parasheh që të mos paguhet dy herë për një asamblist, a vlen për të gjitha komitetet dhe komisionet apo për disa po për disa jo?

Ramiz Rrusta, tha se në ligj thotë që dy komitete janë obligative që duhet paguar, KPF edhe Komiteti për Komunitete, ndërsa anëtarët e komisioneve tjera që janë formuar afër dhjetë i kemi paguar ata anëtarë të cilët nuk kanë qenë, përkatësisht nuk kanë marrë pagë prej BKK, sepse na ka lejuar mundësia, po ashtu na ka lejuar edhe ligji, sqaroi drejtori Rrusta.

Pjetër Coli, pyeti që ky ligj a vlen vetëm për Klinën apo edhe për komunat tjera? “Është pyetje naive, unë e di përgjigjen, e di që nuk praktikohet në këtë formë çfarë po thoni ju në komunat tjera”, tha anëtari Coli.

Tunë Dedaj, tha se unë vetëm desha ta shpreh një mendim timin: “Unë e di që Kuvendi është organi më i lartë i Komunës, edhe vendimet e Kuvendit drejtorët janë të obliguar për t'i zbatuar. Shumë mirë e tha Pjetër Coli që tha për komunat tjera vendimet vlejné. Jam shumë mirë i informuar që në të gjitha komunat në Kosovë komisionet paguhen. Edhe nëse kryesuesi e ka thirrur Kuvendin, mua drejtpërdrejt më ka thënë, që unë i kam thënë grupit tim, që në këtë seancë të jashtëzakonshme paguhen anëtarët, janë mëditjet, atëherë do të thotë unë ose duhet t'ju jap mëditjen prej xhepit tim, ose duhet t'ju jap Kuvendi, dikush duhet kompensuar mëditjen. Këtu është një dëshirë e dikujt të mos i paguajë mjetet”, ka theksuar anëtari Dedaj.

Hasime Dauti, tha më falni zotëri drejtor Rrusta, por a e dini ndonjë komunë që Komisioni për emërtimin e rrugëve nuk mund të llogaritet sikur komisionet tjera dhe asnjë komunë nuk ka mbetur pa paguar këtë komision, bile-bile edhe vendosja e tabelave ka përfunduar me sukses, sipas informimit tim”, pohoi anëtarja Dauti.

Rasim Millaku, tha se për t'i kontribuar realitetit, unë i pari ngrita çështjen e vendimeve që ne si Kuvend i marrim dhe nuk zbatohen nga DE. “Edhe, tekstualisht e thashë se nëse DE nuk ka nevojë për neve le t'i kalojë vendimet e veta në drejtori të vet, di mirë çka kam thënë. Janë dhjetëra vendime që ke marrë ti kryesues, edhe vërejtja është dhënë edhe ndaj teje. Kur vendimet tuaja nuk zbatohen, nuk po komentoj më shumë. Ligjin nuk e komenton drejtorja, por Kuvendi

ka trupa që njohin ligjin më mirë se sa drejtorët, sepse drejtorët gjithë janë politikë, kam qenë edhe vetë drejtor. Jam inxhinier me profesion, edhe kam udhëhequr një dikaster që ka pasur të bëjë më së shumti me ligje, por kam konsultuar plot juristë, edhe kam bindur gjithmonë Kuvendin. Ne kemi ngritur çështjen këtu të komiteteve, së fundmi nuk kem i mbetur në 50 euro të komiteteve, por krejt e ligjshme është për t'u paguar, sepse asnjë komitet aty nuk shkruan, këtë për ta paguar, këtë për të mos e paguar, por të gjitha komitetet duhet paguar, përndryshe nëse nuk ose nuk mbikëqyren që po punojnë, thjesht Kuvendi duhet konsideruar si i mangët, sepse komitetet janë trupa konsultuese të drejtorive, ju ndihmojnë drejtorive pikërisht me ekspertë të llojit të ndryshme. Edhe Kuvendi këtu është i hendikepuar se nuk ia ka dalë etj. Ndërsa, janë dhjetëra vendime, që s'po i përsërisë që i kemi marrë, duke filluar me shërbime për pajisje që na janë nevojitur, vetë kryetari e ka thënë, sa ne nuk kemi kërkuar për t'i marrë ata lap - topë me vete, por thjeshtë për t'u shërbyer për tre vjet, por s'kanë ardhur për shkak të vendimeve të njëanshme të drejtorisë për ekonomi. Atëherë personalisht po them DE çdo pikë që ka le ta kalojë tek Drejtoria e vet, sepse nuk ka nevojë për ne. Për hir të pozicionimit tim, unë abstenoj përderisa të merr përgjegjësi drejtori ose Drejtoria për Ekonomi për këto vendim ose të ligjshme, ose të paligjshme ne i marrim dhe nuk kemi nevojë me marrë vendime nëse duhet dikush për të na i qitur në konsiderim. Shërbimi për punë të Kuvendit kanë juristë, që s'ka duhet punësuar, dhe duhet vërtetuar ligjshmërinë e jo të lihet në vullnetin e individëve”, ka konstatuar anëtari Millaku.

Fadil Gashi, tha se po shoh që nga pak po rrëshqasim edhe në tema tjera, edhe kjo është pjesë e rendit të ditës nëse i qasemi pak më thellë, sepse nëse është bartje e mjeteve, unë po konsideroj se akoma ka hapësirë, edhe ka mundësi për t'u bërë një bartje ashtu qysh mendon edhe ky kuvend bashkë me ekzekutivin. “tash mua nuk po më mbushet mendja te vitet 2015, se ne më 2016 e kemi bërë krejt çka na ka sjellë drejtoria bartje të mjeteve prej 2015-ës. Unë e kam pasur sikur të gjithë anëtarët tjerë të Kuvendit vlerën e këtij aparatit të gjeodezisë, na është bartur që tri vite po më duket. Kjo 297 mijë është shumë e madhe, gati një rishikim i buxhetit po na del. Unë këtë po e them, edhe me këtë nuk po pajtohem. Për të folur për këtë pjesën çka filloi për t'u diskutuar tash, besoni që po e ndjej veten keq, po e ndjej veten keq sepse jam pjesë e atyre gabimeve që edhe unë i kam bërë. Unë jam pjesë e atyre kur kam qenë ulur aty ku jeni ju, edhe unë nuk kam mundur për të bërë zgjidhje. Unë po marr pjesën e fajit për vete, e tani e kemi gjithë anëtarët e Kuvendit që s'mund t'ia dalim me një drejtori. Nuk kam punë as me remizim, as me atë Refki Krasniqin dhe të tjerët kush kanë qenë drejtorë të financave. Nuk kam punë me emra. Një kuvend mos me mund me u marrë me një drejtori, jo e turpshme, aq e ligë është, sa nuk din as emrin për t'ia ngjitur. Nëse ka ardhur në pyetje me qenë një udhëzim më i madh se i ministrit, cilitdo ministër, më i madh se i udhëzimit të Kryeministrit tash në këtë rast, sepse ne e kemi, po e lëmë ligjin krejt, por ti ke një udhëzim të Kryeministrit në atë kohë të Hashim Thaçit, që ju ka dërguar të gjitha kuvendeve komunale, qysh kompensohen anëtarët e Kuvendeve, si kompensohen anëtarët e komiteteve, edhe i kanë me shumta të caktuara, është gjithçka e qartë. Pastaj janë, jo një vendim, por më duket dy vendime janë të Kuvendit, që s'ka pasur nevojë për t'u nxjerrë, sepse vendimi i Kryeministrit është më i madh se sa çdo vendim që marrim ne këtu. Pastaj vijmë deri te çështjet tjera që kemi ndërtuar komisionet nga ky kuvendi. Kush e përmendi komisionin për emërtimin e rrugëve me gjitha ato telashe që i kanë pasur në terren, nuk kompensohen. A mendoni ju që ata që lëshojnë këso udhëzime cilado ministri qoftë, por punëtorët e atyre ministrive në oborr të ministrisë po të dalin për ta bërë një skicë prej ministrie e merr mëditjen. Në oborr të ministrisë, lëre për t'i kaluar rrethojat e ministrisë. Asnjë nuk lëviz

atje pa mëditje. Këtë nuk jam duke e përdorur luks, por merre ti kryesues, këqyre dinamikën e takimeve të komiteteve që i kemi themeluar ne, sa janë mbajtur, sa janë efikase, sa u janë nevojitur si trupa këtij kuvendi, sa kemi mundur për t'u koordinuar me ta? Nuk është problemi këtu a janë 50 apo 100 euro. Është në pyetje pak autoriteti, është në pyetje pak përgjegjësia që ka si kuvend këtu. A i keni parë seancat solemne, si për pavarësi të Kosovës, për ditë të Çlirimit, as 50 për qind nuk janë të anëtarëve të Kuvendit në seanca solemne. Këtu po vijmë që po na jepni para se nuk vijmë ndryshe. As nuk vijmë në KPF ndryshe. Drejtori thotë “nuk i keni planifikuar”. Nuk është detyrë jona për t'i planifikuar. Ne krejt vendimet që po na i sillni këtu po ju përkrahim, pse nuk po i planifikoni ju. Ekzekutivi, tash mua po më duket e keqe të dëgjoj nga drejtori që thotë “nuk i keni planifikuar për seancat e jashtëzakonshme”. Seanca e jashtëzakonshme gjithkund paguhet. Është seancë e rregullt veç koha që i shkurtohet. Është seancë që paguhet, edhe duhet planifikuar. A e pat ju vendimin e fundit në Parlament, ata i rrinë gati vetes. Ata qysh tash po nxjerrin vendimin kush mbetet pa mandat më 2018. Tash po i shikojnë mjetet. Shikoni çfarë mendojnë për vete ata. Një vit përpara i sigurojnë krejt ato mjete dhe i qesin në arkë mjetet, ne shikojmë këtu dhe grindemi mes vete dhe shikohem keq shoqi-shoqin pa asgjë fare”, ka nënvizuar anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi tha se është kontribut sigurisht, janë tema që janë rrahur disa herë në këtë AK, unë mendoj që Kryetari mund të jap kontributin e tij me fjalën e tij.

Sokol Bashota, tha se drejtori e dha shpjegimin rreth këtyre bartjeve të mjeteve që janë bërë për investime kapitale. “Ju e dini fort mirë që Komuna në cilëndo rrethanë tjetër, është dashur për të bërë zhurmë të madhe, por jo forma se si janë arritur për t'u bërë këto të hyra, për arsye se e dini, se ne rregullimin e qendrës së qytetit e kemi pasur me buxhet vetanak dhe këto mjete janë nxjerrë në fund të vitit shumë pak ditë para fundit të vitit, pra në dhjetor, janë nxjerrë nga QK. Thjesht, shumë mjete janë ruajtur të buxhetit komunal. Po ashtu kemi te hartat zonale që janë bartur, sepse ministria nuk është e gatshme për t'i dhënë lejen për t'i funksionalizuar. Këto janë bartur, ne po i lëmë me qëllimin më të mirë se ato 30 mijë euro ka pasur mundësi për t'i shfrytëzuar për diçka tjetër, por thjeshtë për të mos pasur mundësi tani mos me pasur nuk është mirë, kur e marrim dritën e gjelbër për me i bërë këto. Pastaj janë diku 45 mijë euro participimi qytetarëve që janë bërë për investime kapitale, edhe është ky tremujori i fundit që bëhen të hyrat duke u nisur prej tetorit, nëntorit dhe dhjetorit, duke u nisur nga këto të policisë dhe të hyrat tjera që nuk regjistrohen. Prandaj është kjo shumë që është, gjegjësisht totali. Ajo çka dua ta them, rreth pagesës së komisioneve unë bart të njëjtin qëndrim sikurse edhe ju. Realisht çdo vendim që ka nxjerrë kjo asamble ligjshmëria ka ardhur nga MPL. Vendimet që nuk kanë ligjshmëri thjesht ato ose debatohen edhe një herë, nën një. Në dy, të drejtën që kam unë për ta rikthyer një vendim të asamblesë kurrë s'e kam kthyer, përkundër këtij fakti kam insistuar që këto komisione të kompensohen. Rregullimin e brendshëm të shtëpisë sonë kur është në harmoni me ligjet e Kosovës, askush nuk ka mundësi të na përzihet. Ne nuk guxojmë ta lëmë keq një punë tonën për shkak se ministria ka nxjerrë vendime, domethënë kështu në korniza, por gjithmonë mundësitë ligjore të dhënë mundësinë e kompensimit për këto komisione. Një komision që është ligjërish, me ligj, edhe të tjerët që është e rregulluar shumë mirë. Ne kemi vështirësi për t'i zgjedhur kryetarët e fshatrave. Komisioni nuk del, asambleja e ka votuar, është zgjedhur komisioni për t'i zgjedhur kryetarët të caktuar me ligj, komisioni nuk ka mundësi të dal për arsye se nuk ka financa. Dhe kryesisht jemi marrë vesh që takimet të bëhen në mbrëmje ku qytetarët janë të lirë dhe për t'i zgjedhur përfaqësuesit e vet. Pastaj kemi komisionin për emërtimin e rrugëve.

Shikoni, puna partizane dhe puna vullnetare ka ikur moti. Nëse duam të bëjmë diçka për hir të këtij vendi për punët që po ngarkohemi ta kryejmë qysh duhet, me ligj dhe me kompetenca, kjo është. Puna më e mirë që mund t'i shërbejmë këtij vendi. Por për punën që e bën secili, që i merret hapësira e kohë së tij duhet të gjenden mundësitë e kompensimit. Po e them edhe një, po ndaj mendimin e atyre që thanë më herët, Komunat tjera i kanë paguar të gjitha. Në qoftë se ato e kanë shkelur ligjin po e shkelim edhe ne bashkë 26 asamblistë po e shkelim edhe ne, edhe unë po nënshkruaj këtë pagesë. Jo të mbetet puna keq. Anëtarë për Siguri në Bashkësi më nuk vjen, Komisioni për zgjedhjen e përfaqësuesve të fshatrave nuk ka dalë në terren, po ashtu edhe komisionet tjera. Në qoftë se duhet për t'i zgjedhur jashtë asamblesë, atëherë po i kthejmë krejt komisionet edhe një herë në asamble edhe po i zgjedhim jashtë komunës, jashtë institucionit. Të paktën të mos thirremi në atë dhe të pengohet suksesi. Mundësi ka, mbështetjen e ke deri ku të duash, vetëm të kryhet, të mos na vije ne asamble edhe një herë seriozisht shumë çështje, sepse shumë, shumë e rëndë po me duket”, ka konstatuar kryetari Bashota.

Ramiz Rrusta, tha se Fadili mirë e tha që përmendi bartjen e atyre të vitit 2015, këtu hynë ato të 2015-ës që po barten, nuk ka mjete tjera. “Fadil, vetë ke kryesuar Asamblenë, edhe Rasimi si drejtor, me siguri që i dini gjerat. Më kishte çuditur dikush tjetër sikur t'i kishte folur ato fjalë çfarë i the z. Rasim, të planifikimi i buxhetit për të gjitha drejtoritë tjera nuk e bën DF, duhen hapat qysh bëhet planifikimi i buxhetit dhe të gjithë drejtorët e planifikojnë buxhetin e vet për drejtorin. Ti fare mirë e di që ke qenë drejtor i drejtorisë, parashe aty numrin e punëtorëve, parasheh çka ke për të blerë, çka tek. DF gati ne jemi si shërbim teknik. Ju gjithë mllëfin po e keni në drejtorinë tonë, por buxheti sa është i drejtorisë sonë është i juaji. Ky nuk është buxheti i DF, por DF i mbikëqyr, e menaxhon, edhe jam i bindur që në mënyrën më të sigurtë dhe më të mirë jemi duke e mbikëqyrë dhe duke e menaxhuar. Ky është buxheti më i madh, jo që e aprovoni në fund të çdo viti se sa ne që e menaxhojmë. AK e ka buxhetin e vet. I parasheh fare mirë edhe pagesat e juaja dhe ato tjerat. Vijnë shkresat tek ne asnjë dokument, asnjë minutë nuk rri, i përcjellim aty ku duhet dhe bëhen pagesat. Sinqerisht po ju them, urdhëroni, ejani në drejtorin ku punoj bashkë me punëtorët që punojmë bashkë. Mos u merrni me buxhetin e ministrisë, me buxhetin e qeverisë, ne kemi buxhetin çfarë e kemi. E dini fare mirë cili është buxheti për investime kapitale dhe cili është për paga dhe mëditje dhe mallra dhe shërbime. Edhe vetë ne kemi çuar kërkesa për pagesa edhe na janë kthyer prej Prishtinës. Kam qenë njëri prej atyre që unë kam shkuar. Unë jam shkuar edhe nuk kam hasur në mirëkuptim në MPL aty ku kalojnë pagesat, qoftë për koeficient apo diçka tjetër”, ka sqaruar drejtori Rrusta.

Haxhi Ibishi, tha të kthehemi te tema se fort u bisedua për kompensimin e këtyre komisioneve, kryetari e dha një fjalë publike, vendimet janë këto tonat, të kthehemi në temën që kemi rreth bartjes së mjeteve.

Skënder Merturi, tha se sa për fjalë publike e di disa herë qysh janë mbajtur këto fjalë publike të ekzekutivit. “Por, një shumë shkurt po dua ta them: Është duke me çuditur fakti i pozitës te kjo pika e rendit të ditës që po ngre zërin. Kur është puna për të diskutuar te hartimi i buxhetit askush nuk e ngre zërin. Tash po më duket që jemi duke shkuar te zgjedhjet, tash e ngrehin zërin. Kur është hartimi pse nuk i përmendin këto çështje, pse nuk e ngrehin zërin, por tash, po duam të shkojmë në zgjedhje, buxheti ka përfunduar, alkimi i mjeteve është obligim ligjor. Unë personalisht jam kundër, nuk pajtohem, e kam thënë në KPF, por kjo është duke më çuditur, pse tash e ngrehin zërin, jo kur është koha, e paarsyeshme”, ka shtuar anëtarë Merturi.

Ramush Agushi, tha se unë e pata rreth komisioneve këtu, mbasi Ramizi e tha për mundësitë që janë. “Unë kisha propozuar atëherë që këto komisione që janë të rigjedhen edhe një herë, edhe të dalin dhe t’i kryejnë punët e veta. Në qoftë se ka asi njerëz që kryejnë punë vullnetare, atëherë okej, se komisioni që është për zgjedhjen e këshillave të bashkësive, vetëm Komuna e Klinës është që nuk e ka kryer, edhe do të kishte qenë mirë për t’u kryer ajo. Sa i përket Skendës, ne kemi qenë të gjithë kur ka qenë nevoja, edhe pozitë, edhe opozitë, kur nuk ka qenë mirë të gjithë kemi kundërshtuar. Kështu që nuk ka rëndësi ajo këtu. Zgjedhjet të gjithë e dinë që janë, por nuk e kemi për punë të zgjedhjeve, por jemi shumë konstruktivë, edhe gjithë kemi për t’i kritikuar drejtorët, a janë të gjithë apo nuk janë të gjithë, ne kemi për t’i kritikuar”, ka pohuar anëtari Agushi.

Kryesuesi vuri në votim, kërkesën për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake për vitin 2016 në vitin 2017 (ref. Nga DEFZH).

Me 13 vota për, 10 kundër dhe 1 abstenim, u miratua kërkesa e Drejtorisë për FEZH.

Pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, Nr.01-434-5712/2014 të datës 26.12.2014.

Kryesuesi Ibishi foli rreth çështjes në rend të ditës. Fjalën e barti te zyrtari i Drejtorisë së FEZH, z. Ajet Sejdiu.

Ajet Sejdiu, zyrtar i Drejtorisë së FEZH, referoi rreth Draft-rregullores për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, Nr.01-434-5712/2014 të datës 26.12.2014. “KPF-ja dhe AK-ja kanë marrë vendim që ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, të vihen në diskutim publik. “Debati me publikun është mbajtur. Hapat ligjorë janë kryer”, theksoi zyrtari Sejdiu, i cili në vijim foli rreth ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale. Duke folur rreth ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, zyrtari Sejdiu theksoi se nenit 26 të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale te miratuar me dt.26.12.2014, i shtohen edhe 2 paragrafë dhe atë me tekstin siç vijon: “Ankesat e ushtruara kundër vendimeve lidhur me caktimin e taksave, tarifave dhe ngarkesave tjera komunale, rishqyrtohen nga ana e organit i cili e ka nxjerr vendimin, sipas provave të ofruara me ankesë apo edhe atyre të cilat zyrtarisht mund të nxirren nga ATK-ja, Inspektorati komunal kompetent apo edhe regjistri- evidenca adekuate e regjistrimit dhe gjendjes së obligimeve komunale të bizneseve. Paragrafi 2 i këtij neni ka këtë përmbajtje: Afati i paraqitjes së ankesave sipas paragrafit 3 të këtij neni është 8 dite nga dita e pranimit të vendimit. Neni 56 paragrafi 3 pika 1 e Rregullores, ndryshohet dhe atë sa i përket vlerës 20 €, në vend të saj caktohet vlera prej 30 €. Paragrafi 1 dhe 2 i nenit 60 të Rregullores që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e Palestrës Sportive hiqen në tërësi, pasi që parashihen me rregullore të veçantë. Teksti i nenit 41 ndryshohet dhe caktohet teksti i ri siç vijon: Paguesa e taksës në emër të komunalive për objektet e përkohshme bëhet sipas U.A nr.22/2012 të dt.19.12.2012 dhe vendimit të veçante të MMPH-se, nr. 043/2013 të dt.15.03.2013 dhe kjo taksë për leje të ndërtimit është caktuar të jete 2.13 € për m². Neni 42

pika 42.1 fshihet në tërësi dhe në vend të saj caktohet taksa për lëshimin e certifikatës së përdorimit për objekte banimi dhe afariste, caktohet taksa prej 0.10 € për m² bruto”, ka raportuar zyrtari Sejdiu.

Skënder Merturi, tha se tek propozimet që kanë ardhur nga DKRS ku parashihet shfrytëzimi i pajisjeve të zërimit të sallës së objekti të QK “Jehona e Dukagjinit” të caktohet tarifa 50 euro, ko 50 euro unë po propozoj të hiqet tërësisht, se ne e kemi votuar një herë shfrytëzimin e sallës, është 100 euro, tash pse edhe zërimit për ta votuar, 50 euro për zërim. Salla shkon e shfrytëzuar me gjitha pajisjet dhe komplet salla duhet për t’u shfrytëzuar me pajisjet, se ashtu e kemi votuar një herë 100 euro, tash plus 50 euro. Unë po propozoj këto 50 euro të hiqen tërësisht dhe të mbetet ajo tarifa që kemi votuar të gjithë këtë”, ka theksuar anëtari Merturi.

Arben Limani, tha se ne si grup i asamblistëve edhe në seancat përpara kësaj e kemi potencuar disa herë shikimin e mundësisë së lirimit nga tarifat komunale të lokaleve që operojnë në pjesën ku po ndërtohet sheshi dhe kemi kërkuar nga drejtori i financave, por edhe nga ekzekutivi në përgjithësi që bashkërisht, me ndihmën edhe të Kuvendit ta shohim mundësinë e ndihmesës ose përgjysmimit ose ta gjejmë një mundësi për t’ju lehtësuar sadopak këtyre bizneseve që operojnë në pjesën e sheshit ku po punohet. “Drejtorja është munduar disa herë të na jep përgjigje, edhe kryesisht përgjigja na është dhënë sipërfaqësisht. Kishte qenë mirë, ekziston kërkesa edhe e bizneseve që të ndërmerret diçka në këtë drejtim”, ka shtuar anëtari Limani.

Tunë Dedaj, tha se e tha edhe Arbeni, por edhe ne si grup, e patëm në plan vetë ta propozojmë, mirëpo mbështesim propozimin e Arbenit që këto lokale që janë rreth sheshit të lirohen komplet nga tatimi në pronë përderisa të përfundojë sheshi, për arsye se janë të dëmtuar drejtpërdrejt, duke marrë parasysh që ndërtimi i sheshit ata i pengon në realizimin e të hyrave të tyre”, shtoi anëtari Dedaj.

Sokol Bashota, tha se do të ndalem tek kjo çështje: absolutisht asnjë kërkesë nuk e kemi prej afarizmit për me u kompensuar as për t’u liruar nga pagesa absolutisht dhe absolutisht nuk ka ndryshuar asgjë në realizimin e të hyrave. Ne i kemi liruar edhe dy rrugë anësore që po punojnë makinat nëpër trotuar, furnizimi është i rregullt, edhe në pjesën kryesore të rrugës deri tek Komuna, ecet edhe mbi galeri. Kemi pasur vërejtje pikërisht prej operatorit, punëkryerësit, për ta bërë një gjë të tillë, për ta bllokuar më shumë rrugën, për shkak se një makinë të një qytetari që kanë aksidentuar gjatë operimit, është qitë në gjyq edhe thjeshtë duhet kompensuar dëmin dhe na kanë thënë a po na lejoni galerinë të punojmë të lirë. Nuk i kemi dhënë komplet pikërisht për këta afaristë që janë në të dy anët e rrugës. Në qoftë së veç duam të ndërmarrim një gjë të tillë mund ta mbyllim komplet ne rrugën e të jeni të sigurt që ata kanë për të lypur që të punojnë në këto kushte çfarë janë duan për të punuar, jo ndryshe. Nuk është e vërtetë ajo që ata janë duke u penguar në punët tyre as në furnizim, as në qasje të qytetarëve, as fare. Asnjë vërejtje si ekzekutiv deri me sot nuk e kemi, deri me sot, edhe ata janë të vetëdijshëm për këtë. Pastaj, janë do taksa, që është mirë për t’i lexuar mirë ligjet për disa ndryshime që ndodhin ato janë të përcaktuara me ligj”, ka theksuar kryetari Bashota.

Tunë Dedja, tha se Kryetar, më vjen keq por realisht po të këqyret këto lokale janë të penguar në punët e tyre, edhe unë ju garantoj që jo një, por mbi 20 vetë mua drejtpërdrejt më kanë thënë që është mirë për t’iu hequr tatimin në pronë, minimumi është 20 qytetarë më janë drejtuar e unë

një zë qytetari po e sjell në Kuvend. “Edhe nëse jo, unë do ta kisha pyetur drejtorin, a tatimohet njëjtë, sikur një lokal që është midis qendrës sikur një që është në periferi. Do të thotë ai lokal që është midis qendre, është kategori e parë që tatimoret me çmim më të lartë, ai lokal që është në periferi është paraparë që fiton me pak dhe paguan me pak. Unë kisha kërkuar që kjo të bëhet për arsye për lehtësim të qytetarëve”, ka theksuar anëtari Dedaj.

Arben Limani, tha se unë po i referohem një kërkesë të një grupi të bizneseve që operojnë në qendër, e kam parë edhe listën. “Pas kërkesës që kam bërë në asamble këtu drejtorit të financave dhe ekzekutivit për gjetjen e një mundësie për lehtësim, askush nuk e ka thënë për heqje e atyre taksave, por për gjetjen e një mundësie për lehtësim, domethënë për t’i dakorduar të gjithë bashkë edhe ne si kuvend, që sado pak t’ju lehtësojmë se nuk është e vërtetë që nuk janë duke u penguar bizneset, kush e sheh nëpër Klinë e di se secili prej bizneseve që operon këtu ka pengesa si me furnizim, si me lëvizje. Ne kemi kërkuar këtë, edhe unë edhe iniciativën e kam parë për grumbullim edhe të nënshkrimeve, por me reagimin e drejtorit që është problem për vitin që shkojë, se kjo është trajtuar edhe në vitin që ka shkuar, është problem për të hyrë viti që kaloi, edhe i kam informuar, thjesht, është një iniciativë që s’po gjen shumë mbështetje edhe e kanë ndërprerë. Unë i kam parë edhe nënshkrimet që i kanë tubuar, por nuk i kanë prurë për shkak të atij refuzimi po e them, kështu që është dhënë gojarisht prej drejtorit. Edhe një sqarim prej drejtorit të arsimit desha, te kërkesa që ka bërë për ngritje të shumës edhe përmirësimit të nenit 56, domethënë nga shumë 20 në 30 euro. Unë desha për t’u sqaruar prej drejtorit që sa është kjo shumë 20 euro që paguhen për fëmijë, a është që nga koha kur është miratuar rregullorja, më 29.8.2014, kjo shumë, se po kërkohet ndryshimi i shumës prej 20 në 30 euro, kur e di që prindërit para 2-3 muajve kanë paguar nga 25 euro për fëmijë, se kam pasur edhe vetë fëmijën aty. Domethënë prej kur është kjo shumë”, ka thënë anëtari Limani.

Pal Berisha, tha se desha vetëm të them se është e nevojshme për ndryshim të rregullores. “Zotëria Ajet Sejdiu të na sqaron edhe një herë, sepse ne në KPF kemi marrë material tjetër që ka propozuar për ndryshim, ndërsa Ajeti edhe në KPF edhe sot referon të përmbledhura pikat. Unë mendoj që duhet të sqarohen edhe një herë në detaje pikat cilat propozohen që të ndryshohen në Rregulloren për tarifa”, ka shtuar anëtari Berisha.

Haxhi Ibishi, tha se ky është propozimi në bazë të debatit me publikun, në bazë kërkesave që kanë ardhur nga drejtoria dhe është propozim final i ekzekutivit karshi asamblesë. “Asambleja e sheh të arsyeshme për t’i votuar këto ndryshime apo për të mos i votuar. Ky është propozimi final i diskutimeve i mbledhjes së procedurave që kanë mbërritur deri këtu nga ekzekutivi”, sqaroi Kryesuesi.

Ramiz Rrusta, tha se desha t’i përgjigjem zotit Tunë se ne nuk kemi kompetencë jona të lirojmë askënd prej tatimit në pronë as e AK, e cila pasurinë e paluajtshme tatimore a është funksional apo nuk është funksional, ligji këto i përcakton. Ndërsa te taksat e bizneseve fare mirë edhe me Arbenin kemi biseduar. Vetëm një pyetje po ju bëj, cili prej juve e pengon shkuarja në bankë për të tërhequr pagën apo për të deponuar mjete në bankë? Çka e pengon? Afarizmin kryesor prej bizneseve edhe taksën më të madhe që paguajnë e kemi prej bankave, kemi edhe institucionet financiare private tjera, që të gjitha e përshkruajnë këtë rreth. Nëse ju doni që ne të mos kemi të hyra, mos të inkasojmë taksë komunale, që të mos e mbushim arkën e Komunës dhe të mos ketë projekte në të ardhmen, atëherë jo disa procedura tjera që mund të bisedohet përmes AK. Jam

duke e thënë edhe një, që nuk është pengesë aq e madhe, sepse askënd nuk po e pengon për të shkuar për të pirë kafe përballë Komunës që është plot, edhe biznese tjera”, ka shtuar drejtori Rrusta.

Hajdin Morina, tha se kërkesa jonë është paraqitur më herët, me kohë, kemi bërë përpjekje për t'i zënë të gjitha kriteret zyrtare. “Ajeti e ka paraqitur edhe tash, edhe në debatin me publikun, edhe në KPF. Është e vërtetë qysh po thotë Arbeni, ka qenë një periudhë kur është apguar 25 euro jo 20 euro, mirëpo ajo 25 euro normalisht është që është dorëzuar në arkën e Komunës. Hollësitë më të mëdha i di drejtoresha, auditimi kur ka qenë, normalisht është kërkuar, ne jemi pjesë e atij auditimi. E ka kërkuar vendimin që ka parë 25 euro. Paska qenë një vendim, nuk di saktë kush ka qenë drejtor. Mirëpo, është e vërtetë që është paguar 25 euro duke menduar që pak është 20, ndërsa tash për shkak të autitimit që ka kërkuar 20, ne mund të shkojmë në 20, por nuk është e logjikshme kur është në pyetje 20-shi, sipas argumenteve të mia, kurse ne si drejtori pajtohemi me vendimet që merr AK e Klinës. Sepse e kam thënë në debat me publikun, edhe në KPF janë shtuar shërbimet, janë shërbime bukur cilësore tashmë në çerdhe; janë shtuar metrat katrorë, është shtuar numri i fëmijëve. Ju merrni vendim sipas argumenteve tuaja, ne kemi argumentet tona, një shumë prej 30 euro është një shumë që nuk është më lirë në rajon, 20 nuk e kanë asnjë. Plus janë shtuar 2 punëtorë më shumë, Komuna i ka parasysht ata i paguan. Shkurt, janë rritur shërbimet aty dhe janë rritur paratë që shpenzon Komuna”, ka sqaruar kërkesën drejtori Morina.

Kryesuesi vuri në miratim ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, Nr.01-434-5712/2014 të datës 26.12.2014.

Me 23 vota për, 1 abstenim, pa kundër u miratua ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, Nr.01-434-5712/2014 të datës 26.12.2014.

Pika e pestë: Shqyrtimi dhe miratimi i Ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për ndarje të bursave për studentët e Komunës së Klinës.

Haxhi Ibishi, tha se ju i dini procedurat të cilat i kemi zhvilluar deri me tash në përgjigje të një kërkesë të një komisioni tonë që ka miratuar kjo AK, për ndryshim të një pike të Rregullores.”Komisioni ka propozuar që kemi kaluar të gjitha hallkat pika ku ka qenë “likuidimi i vitit” si parakusht për ndarjen e bursave të hiqet dhe të vendoset “fitimi i kushtit”. Domethënë regjistrimi i vitit, jo likuidimi, por regjistrimi. Unë mendoj që të gjitha partitë politike në KPF janë dakorduar kështu, në qoftë se ka ndokush tjetër diçka le të urdhërojë”, shtoi kryesuesi.

Nuk pati debate rreth çështjes në rend të ditës.

Me vota unanime (24), u miratua propozim-ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për ndarje të bursave për studentët e Komunës së Klinës.

Pika e gjashtë: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për subvencionimin e Festivalit Folklorik “I Këndojmë Lirisë” 2017.

Haxhi Ibishi, tha se edhe këtu ka qenë dakordancë e plotë edhe në KPF, nëse ndokush e dëshiron fjalën, hapi debatin.

Fadil Gashi, tha se kryesues një vërejtje po ju jap, më parë e thatë “kemi për të qenë efikas”, efikas dhe i shpejt dallojnë, efikas ishim edhe në të parat, edhe pse u vonuam, ndërsa të shpejt mund te jemi, efikas ishim deri tash të gjithë. “Për pjesën e festivalit e kam thënë edhe në KPF, është absolutisht e panevojshme, për mua ka qenë e pakuptimtë, edhe sot është, me na prurë në kuvend ndarjen e mjeteve ku ne i kemi planifikuar në buxhet. Ne e kemi bërë miratimin e buxhetit, janë të planifikuara këto mjete. Janë ndarë mjetet për festival, çka duhet tash ky vendim shtesë. Mbasi kam kërkuar në KPF që doni tash me u kthyer dhe të na jepni një raport kthyes është diçka tjetër, edhe më mirë. Nëse ju e keni filluar doni për t’i ndarë , por në fund kur të kryhet krejt festivali, të kryhen krejt pagesa e të tjera çështje, të na sillni një raport kthyes do të kishte me qenë mirë. Edhe kjo është kështu”, tha anëtari Gashi.

Kristina Lazri, tha se është e vërtetë që ne në linjën buxhetore po i diskutojmë dhe po dihet shuma e mjeteve që ndahen për festival. “Mirëpo vitin e kaluar, do të thotë ne kemi marrë si rekomandim, pasi që kemi edhe në rregullore mbi 2 mijë euro nëse duhet të votohet detyrimisht në AK, ne u obliguam që ta sjellim këtu para jush në mënyrë që ta votojmë këtë shumë, për arsye se është subvencion edhe Auditori i Jashtëm, domethënë na ka dhënë rekomandim që duhet të votohet në AK”, ka sqaruar drejtoresha Lazri.

Haxhi Ibishi, edhe Kryetari zotohet se pasi që të kryhet festivali gatishmëria edhe e përgjegjësive të festivalit që menaxhon atë është që të përgatitet një raport për çdo cent që shpenzohet dhe është shpenzuar si kontribut për festivalin “I këndojmë lirisë”.

Kryesuesi vuri në votim kërkesën e DKRS-së.

Me vota unanime (22) për u votua kërkesa e DKRS-së për subvencionimin e Festivalit Folklorik “I këndojmë lirisë” 2017.

Pika e shtatë: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për ndarje të ngastrës për ndërtim të Qendrës Rinore në Klinë,

Kryesuesi fjalën e barti te drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtjes së Mjedisit, z. Baki Gashi.

Baki Gashi, sqaroi kërkesën. “Ne si drejtori në bashkëpunim me drejtorinë për Kadastër pas nënshkrimit të memorandumit për ndërtimin e Qendrës Rinore, në mes të Kryetarit të Komunës dhe Ministrisë së Kulturës, e kemi bërë si propozim atë parcelën afër Palestrës sportive dhe kemi bërë një skicim ku ndahen 15 ari për ndërtimin e kësaj qendre rinore. E kemi kryer thjesht një punë teknike që është në kompetencë të drejtorisë sonë”, sqaroi drejtori Gashi.

Kryesuesi vuri në miratim kërkesën e DU dhe MM.

Me 22 për, pa kundër, pa abstenim u miratua kërkesa e DU dhe MM.

Pyetja e tetë: Pyetje dhe përgjigjeje nga këshilltarët e Kuvendit.

Lorenc Marleku, tha se unë kam një pyetje, deri ku është shkuar me fillimin e shkollës fillore, e kemi pasur shumë urgjente, para vitit të ri është vendosur, deri ku ka mbërri dhe kërkoj prej Kryetarit një sqarim rreth kësaj çështjeje.

Petrit Palushi, tha se në seancën e kaluar kam kërkuar analizat e ujit për vitin 2017, nënkryetari ka premtuar që do t'i sjell, por nuk i ka prurë.

Skënder Merturi, tha se ndoshta kryetari mund të përgjigjet se drejtori për financa shkoi. “Është dalë në opinion lidhur me kushtëzimet që ka dalë prej Avokatit të popullit. Mua po më intereson, a e kushtëzon Komuna e Klinës lëshimin e taksës komunale, domethënë tatimit në pronë për regjistrimin e automjeteve, në cilin ligj bazohet kur ka dalë se është antikushtetuese tash. Domethënë Komuna e Klinës a i kushtëzon qytetarët për regjistrimin e automjeteve për tatimin në pronë kur duhet se ka dalë antikushtetues. Nëse po, në cilin vendim ose në cilin ligj bazohet Komuna e Klinës. Nëse mundet të më përgjigjet në këtë seancë është mirë, nëse jo, Zyra ligjore le te merret dhe ta bien përgjigjen me shkrim në seancën e ardhshme”, ka shtuar anëtari Merturi.

Enver Gashi, kam një pyetje për drejtorin e Arsimit: kur do të pajisen shkollat e reja me inventar, domethënë nxënësit kur do të mësojnë në ato shkolla të reja, siç janë Përqeva, Këpuzi?-shtroi pyetjen anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se po që se ekzekutivi është i gatshëm të përgjigjet tash ose në seancën e radhës, vetëm desha një digresion të bëj: Petrit Palushi ka kërkuar prej seancës së kaluar çështjen e analizave të ujit të pijshëm. Sa unë jam në dijeni, Drejtoria e Shërbimeve ose Inspektorati duhet të jap sqarime.

Petrit Palushi, tha se nënkryetari ka premtuar që do t'i sjell, mirëpo nuk i ka sjellë.

Haxhi Ibishi, theksoi që në seancën e radhës do t'ju jepet përgjigja.

Sokol Bashota, tha se sa i përket shkollës, me pasur shpenzuar kaq energji sa është shpenzuar energji për të penguar ndërtimin e shkollës “Ismet Rraci”, kishit mundur të merrni përgjigje më adekuate, se deri ku kanë shkuar punimet. “Ministria e Arsimit është duke e bërë projektin zbatues për objektin e shkollës për t'ia dhënë kompanisë për ta implementuar në terren. Leja nuk mund të lëshohet pa qenë edhe projekti zbatues detal, është fjala. Projekti ideor i shkollës është, por ata kanë kërkuar për ta bërë në tre kopje, një t'i mbetet Komunës, një në ministri dhe një për ta pasur operatori. Inventari nëpër shkolla vjen shumë shpejt, pritet të vijë në javën e ardhshme, kështu janë premtimet e zyrtarëve të ministrisë. Kërkesat dhe procedurat më duket se kanë përfunduar, prandaj pritet për të ardhur në javën e ardhshme”, ka sqaruar kryetari Bashota.

Haxhi Ibishi, tha se në pikën e nëntë të rendit të ditës, Kryetari ka kërkuar për të përfshirë një kërkesë të kryetarit për një njoftim.

Sokol Bashota, tha se duke qenë i hendikepuar seriozisht për këto mbledhjet e jashtëzakonshme që po i ka AK, për të mos dashur për ta thirrur edhe një takim të radhë, e shfrytëzoj rastin që sot,

në këtë muaj që vjen e kemi përvjetorin e ish- kryetarit të Komunës, Ismet Rraci, që do të organizohet nën patronatin tim, si kryetari i Komunës së Klinës. “Duke dashur që të njoftohen të gjitha subjektet politike, asamblistët, drejtorët e drejtorive dhe gjithë qytetarët e Komunës së Klinës, që të jenë të pranishëm dhe shumë shpejt do të bëjmë edhe agjendën e atij evenimenti. Por ajo çka më duhet edhe mbështetja e besimit tuaj, sot, për të mos e thirrur edhe një seancë tjetër është se unë do t’i propozoj AK, që ish-Kryetari i Komunës së Klinës, z. Ismet Rraci, që më duhet prezantuar një biografi shumë të shkurtër, që mendoj se të gjithë keni pasur rastin për ta njohur, dikush e keni pasur edhe bashkëpunëtor shumë të mirë. Është një nga figurat më emblematike të Komunës së Klinës, një njeri ka dhënë shumë, jo vetëm për arsimin, por jo edhe vetëm për të qeverisur me Komunën e Klinës, mirëpo ishte një njeri i devotshëm me të gjitha përpjekjet gjatë kohës së tij, si i vetëdijshëm që në moshën madhore e deri në momentin kur ka rënë në shërbim të këtij vendi. Prandaj, në bazë të kompetencave që kemi, ne si komunë, ju propozoj që Ismet Rracin ta shpallim NDERI I QYTETIT. Mendoj që është një njeri që meriton ta ketë këtë nder edhe vetë qyteti ta ketë këtë nder. Prandaj, për të mos thirrur edhe një seancë kisha kërkuar që të votohet sot për t’i ndarë këtë çmim për arsye se seanca e rregullt do të jetë pas përvjetorit. Kështu që kisha propozuar që ta votojmë sot në mënyrë që të procedojmë pastaj edhe me punët tjera teknike të cilat do të jenë në shërbim të këtij evenimenti”, është shprehur kryetari Bashota.

Haxhi Ibishi, tha se unë thjesht i bashkëngjitëm kontributit historik të etapave të caktuara për punën që ka bërë ish-kryetari Rraci, edhe unë besoj që ndokush prej asamblistëve të grupeve kuvendare e dëshiron fjalën, Fadili në këtë rast, Halili dhe të tjerët dhe pastaj të procedojmë

Fadil Gashi, tha se unë po e përshëndes iniciativën e Kryetarit. “Me ju thënë të drejtën nuk e dita çfarë deshi për të na njoftuar. Mua më kanë kontaktuar familja edhe më kanë komunikuar këtë iniciativë që kanë biseduar me ju, edhe më Zyrën e Kryetarit. Nuk e kam ditur që del në këtë seancë, por nuk është e vonuar absolutisht, edhe në çfarëdo kohe që marrim vendim, neve nuk na shtyn për të menduar a po gabojmë apo s’po gabojmë. Një kisha dashur të kem mirëkuptim, për ta vendosur në rend të ditës, jo në Të ndryshmet, nëse ka vullnet seanca, sepse nuk meriton për të qenë në Të ndryshme. E përmirësojmë këtë me vullnet të krejt seancës edhe kërkojmë pikë e veçantë le të jetë, e nënta ose e dhjeta e kryetarit, të mos jetë në Të ndryshme. Çka u bisedua në të ndryshme, u bisedua krejt ajo figurë që ne po themi për Ismet Rraci. Le të jetë e definuar në rend të ditës dhe për çështjet tjera. Ne zakonisht kur kemi mbajtur akademi përkujtuese, gjithmonë Komunën e kemi lënë në rend të parë, pavarësisht kush e udhëheq Komunën, sepse ai ka rënë në krye të detyrës, ka qenë kryetar i Komunës para se të jetë i veshur me petkun politik, edhe asnjëherë nuk dëshirojmë për t’ia hequr petkun institucional. Unë po ju përgëzoj dhe ne jemi pjesë e gjithë aktivitetit që zhvillohet në këtë drejtim”, ka konstatuar anëtari Gashi.

Haxhi Ibishi, tha se ta fusim në rendin e ditës me propozimin e Kryetarit të Komunës dhe dakordancën e gjithë juve.

Kush është që të futet si pikë e rendit të ditës?

Me vota unanime u miratua propozimi si pikë e nëntë e rendit të ditës, Ndarja e Çmimit Nderi i Qytetit, me propozimin e Kryetarit – për ish- Kryetarin e Komunës të klinës, z. Ismet Rraci.

Miratohet propozimi që propozimi i Kryetarit të futet si pikë e rendit të ditës.

Kryesuesi kërkoi nga kryetarët e grupeve të anëtarëve që të deklarohen në propozimin e dhënë nga kryetari Bashota.

Halil Desku (PDK), tha se fillimisht e mbështesim kërkesën e kryetarit Bashota për dhënien e këtij titulli, “Nderi i Qytetit” për ish-kryetarin e Komunës, z. Ismet Rraci. Njëherit e mbështesim të gjithë si grup. Jemi të nderuar ne si AK që po ë bëjmë një hap të këtillë me propozimin e Kryetarit. Do të kishim ardhur edhe në një seancë të jashtëzakonshme, edhe pse Kryetari e gjeti mundësinë që të bëjmë sot. Ne jemi të nderuar dhe votojmë të gjithë”, ka pohuar anëtari Desku.

Arben Limani (LDK), tha se edhe ne si grup e mbështesim iniciativën e kryetarit për dhënien e titullit “Nderi i Qytetit” për figurën e ndritur të Klinës dhe të gjithë Kosovës, mësuesin dhe veprimtarin e njohur Ismet Rraci. Edhe ne si grup e përkrahim plotësisht,” ka shtuar anëtari Limani.

Tunë Dedaj (AAK), tha se edhe ne në emër të AAK-së e falënderojmë Kryetarin për marrjen e iniciativës që ismet Rraci të shpallet “Nderi i Qytetit”. “E kemi njohur të gjithë, e kam njohur personalisht. Për mua ka qenë një figurë shumë e ndritshme. Ka qenë një personalitet i cili i ka kontribuar shumë çështjes kombëtare. Falënderoj për iniciativën e Kryetarit!” shtoi anëtari Dedaj.

Ndue Shabanaj (IPK), tha se e përshëndesim iniciativën e Kryetarit, edhe e mbështesim plotësisht. “kjo është një iniciativë që meriton mbështetjen e përgjithshme. Unë besoj se jo vetëm nga kjo asamble, por të të gjithë qytetarëve të Komunës së Klinës. Është më të vërtetë meritë për këtë. Dhe nuk ka diçka tjetër për të thënë përpos asaj përpos dhënies së një mbështetje të plotë, edhe është momenti për ta nderuar edhe si Kryetarin parë të Komunës të zgjedhur me votën e lirë, tani të ndjerin z. Ismet Rraci, por me këtë vendim nderon edhe AK vetveten dhe nderon gjithë qytetarët e Komunës së Klinës”, ka vlerësuar prof. Shabanaj.

Skënder Merturi (Grupi 3 Plus), edhe pse i ri në moshë, po ndjehem shumë krenar që jam pjesë e këtij vendimi për të nderuar një figurë kaq të madhe që ka pasur Klina. “Dhe, jam shumë krenar që jam pjesë, përkatësisht që votoj pro nderimit dhe respektit më në fund që po i bëjmë Kryetarit të parë legjitim të komunës së Klinës. Edhe ne si grup e mbështesim qëllimin dhe idenë dhe e përkrahim këtë iniciativë që ka marrë kryetari i Komunës”, Sokol Bashota.

Kryesuesi vuri në votim propozimin e Kryetarit Sokol Bashota, që për kontributin jetësor, patriotik edhe në edukimin e brezave t’i ndahet çmimi “Nderi i Qytetit” (Post mortum), Ismet Rracit.

Me vota unanime u miratua propozimi.

Kryesuesi falënderoi anëtarët për kontributin e dhënë.

Seancën e deklaroi të mbyllur.

Seanca përfundoi në orën 14.30 minuta.

Procesmbajtësi,
Mikel GOJANI

